



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr. 18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 605/5 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M

Nr.170 , datë 30.12.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 605/1, datë 10.10.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 605 prot., datë 03.10.2016, për disa pretendime të ngritura në lidhje me zhvillimin e procedurës së ecurisë disiplinore për punonjësen
*****,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin që përmbante kërkesa e paraqitur prej nëpunëses ***** , bazuar në nenin 16, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", me urdhrin nr. 605/1, dt. 10.10.2016, nisi verifikimin e çështjes, në përfundim të të cilit, rezultoi sa më poshtë:

Nëpunësja ***** është nëpunëse civile me detyrë "Specialist në Sektorin e Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve", në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave, pozicion në të cilin është emëruar rregullisht, nëpërmjet konkurrimit të hapur, të zhvilluar nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.

Sipas përshkrimit të pozicionit të punës, ndër detyrat funksionale të kësaj punonjëseje përfshihet dhe administrimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave "Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale". Meqenëse ushtron një detyrë të tillë, në zbatim të nenit 4/1, të vendimit nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, ...në institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e

prefektit”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Patentave dhe Markave, me shkresën nr. 217 prot, datë 04.06.2016, ka kërkuar para organeve kompetente, miratimin e përfitimit të shtesës së pagës për nëpunësen *****, për shkak të natyrës së veçantë të pozicionit të punës. Kjo e drejtë ligjore e ankueses, është miratuar prej këtyre të fundit, siç rezulton nga përmbajtja e shkresës nr. 39966/1 prot., datë 20.07.2016, të Departamentit të Administratës Publike dhe shkresës nr. 3180/177, datë 26.07.2016, të Ministrisë së Financave.

Pas miratimit të shtesës së mësipërme të pagës, nëpunësja ***** , me detyrë në pozicionin “Përgjegjësi i Sektorit të Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve”, me shkresën nr. 252 prot, datë 26.07.2016, ka filluar ecurinë disiplinore ndaj nëpunëses ***** , me motivacionin: “Shkelje e rregullave të etikës dhe sjelljes së parregullt gjatë kohës në punë, me eprorët dhe kolegët” duke caktuar dhe ditën për shqyrtimin e shkeljes në dt. 02.08.2016.

Pak ditë pas shqyrtimit të ecurisë së mësipërme, me shkresën nr. 276 prot, datë 04.08.2016, drejtuesja e sektorit në fjalë, ka filluar një tjetër ecuri disiplinore ndaj nëpunëses ***** , me motivacionin: “Shkelje e rregullave të etikës dhe sjelljes së parregullt gjatë kohës në punë, me eprorët dhe kolegët. Mosvënia në dajeni dhe mos marrja e miratimit nga përgjegjësi i sektorit për procedurën e ndjekur, për miratimin e kërkesës për përfitimin e shtesës së pagës, për kushte të veçanta të pozicionit të punës”.

Pas shqyrtimit të ecurisë së dytë, në datën 26.08.2016, rezulton se nëpunësja ***** e ka përmblyllur procesin me vendimin nr. 329 prot, datë 16.09.2015, për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses ***** . Ky vendim i është njoftuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 332 prot, datë 16.09.2016.

Njëkohësisht, nga të të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit administrativ, rezulton se institucioni në hetim, mbështetur në këto zhvillime, nuk e ka filluar akoma zbatimin e shtesës së pagës për kushte të veçanta të punës për punonjësen ***** , prej momentit të lindjes së kësaj të drejte deri më sot.

Nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se procedura e ecurisë disiplinore e zhvilluar ndaj nëpunëses ***** ka mangësi të elementëve thelbësorë proceduralë, të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Në rastin në fjalë, ecuria disiplinore ka filluar me motivacionin e shkeljes së rregullave të etikës dhe sjelljes së parregullt, gjatë kohës në punë, me eprorët dhe kolegët, të cilat në kuptim të nenit 57, pika 4, germa “b” dhe “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, klasifikohen si “shkelje të lehta disiplinore”. Në përmbajtje të po këtij ligji, në nenet 59 dhe 60, të tij përcaktohet se, për shkeljet e lehta disiplinore parashikohet dhënia e masës disiplinore “Vërejtje” dhe se, organi kompetent për dhënien e kësaj mase disiplinore është eprori direkt, i

cili ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për fillimin dhe përfundimin e procedimit disiplinor.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 1/e, të nenit 4, jep përkufizimin e eprorit direkt, ku përcaktohet edhe se cili nëpunës paraqitet me këtë cilësi, sipas rasteve të mëposhtme:

- i) *Titullari i institucionit për nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese, përfshirë nëpunësit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;*
- ii) *Sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicionin ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;*
- iii) *Titullari i institucionit të varësisë për drejtorët brenda këtij institucioni;*
- iv) ***Drejtor i drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera.***

Nga sa më sipër, duke analizuar rastin konkret, rezulton se nëpunësja *****, e cila ushtron detyrën në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Financës, Shërbimeve dhe Publikimeve”, në kuptim të ligjit, nuk mund të paraqitet në cilësinë e eprorit direkt në rastet e zhvillimit të ecurisë disiplinore, për pozicionet e nivelit ekzekutiv dhe në rastin konkret për nëpunësen *****. Kjo përcakton se, në kuptim të nenit 59, pika 1, të ligjit të sipërcituar si dhe pikës 1, Kreut 1, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, procedura e ecurisë disiplinore nuk është zhvilluar nga organi disiplinor kompetent.

Pretendimi i nëpunëses ***** (i parashtruar në shkresën e datës 14.09.2016, “Kthim përgjigje”) se, mungesa e pozicionit të punës “Drejtor Drejtorie Finance”, në strukturën e institucionit të mbikëqyrur, legjitimon këtë të fundit të paraqitet në cilësinë e eprorit direkt për nëpunësit civilë, që ushtrojnë detyrën në pozicionet e nivelit ekzekutiv brenda këtij sektorit, vjen si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të përkufizimit të eprorit direkt të përcaktuar në nenin 4, pika 1/e, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga analiza e strukturës aktuale të institucionit (strukturë e miratuar me urdhrin nr. 80, datë 12.06.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave”), Sektori i Financës, Shërbimeve dhe Publikimeve ka varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar dhe në respektim të shkallës hierarkike, nëpunësi që ushtron detyrën në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”, paraqitet në cilësinë e eprorit direkt për nëpunësen *****. Në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përgjegjësi i sektorit, për nëpunësit civilë të emëruar në pozicionet e nivelit ekzekutiv, gëzon vetëm statusin e nëpunësit më të afërt sipas hierarkisë institucionale, në lidhje me përmbushjen e detyrave të nëpunësit, por jo atë të eprorit direkt. Nga analiza e dispozitave ligjore të mësipërme, konkludohet se procedura disiplinore e zhvilluar ndaj nëpunëses *****, si dhe aktet administrative të dala në kuadër të këtij procesi janë të kundërligjshme, pasi rezultojnë të jenë kryer në kapërcim të kompetencës.

Nga ana tjetër rezulton që masa disiplinore “Vërejtje” ndaj nëpunëses ***** , është marrë për veprime të cilat nuk përmbajnë elementë të shkeljes disiplinore. Nga përmbajtja e procesverbalit të datës 26.08.2016 dhe të vendimit nr. 329 prot, datë 16.09.2016, për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” ndaj nëpunëses ***** , rezulton se si shkelje disiplinore është konsideruar procedura e ndjekur nga institucioni për miratimin e përfitimit të shtesës së pagës, për natyrë të veçantë të pozicionit të punës, pa marrë pëlqimin e nëpunëses ***** , me cilësinë e “Përgjegjësit të Sektorit të Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve”.

Në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kërkesa për përfitimin e shtesës së pagës, nuk përmban elemente të një shkelje disiplinore. Kërkimi i saj përbën një të drejtë legjitime të nëpunësit civil, e drejtë e cila garantohet shprehimisht në nenin 34, të ligjit të sipërcituar ku në pikën 2, përcaktohet se: “Paga e nëpunësit civil përbëhet nga paga bazë e kategorisë, shtesa për klasën, së cilës i përket pozicioni, dhe **shtesa për kushtet e punës**”. Në zbatim të kësaj dispozite, me vendimin nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, në pikën 4/1 të tij, është parashikuar shtesa e pagës për ato pozicione të shërbimit civil, që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike, pas plotësimit të disa kërkesave specifike.

Akti normativ i sipërcituar, në të njëjtën dispozitë përcakton dhe procedurën që duhet të ndiqet në rastin konkret, sipas së cilës: “Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të punës”. Në përmbajtjen e këtij akti normativ, në asnjë moment nuk parashikohet domosdoshmëria e dhënies së pëlqimit nga ana e përgjegjësit të sektorit. Për më tepër, rezulton se gjithë kjo procedurë është kryer me dijeninë e drejtuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, i cili ka nënshkruar kërkesën para organeve kompetente për miratimin e shtesës së pagës për punonjësen ***** .

Rrethanat e mësipërme, për ligjin të drejtën e nëpunëses ***** , për përfitimin e shtesës së pagës, e drejtë e cila vazhdon t’i mohohet padrejtësisht, duke mos iu paguar shtesa e pagës, për kushte të veçanta të pozicionit të punës. Në kushtet, kur efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj të drejte, në kuptim të nenit 4/1, të vendimit nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, fillojnë nga data 1 Janar 2016, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave duhet të marrë masa për vënien në zbatim të saj.

Në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunëses ***** , konstatohen disa parregullsi në lidhje me afatet ligjore, si dhe emërtesën e shkresave të cilat materializojnë këtë proces, të cilat përcaktojnë pavlefshmërinë e këtij veprimi administrativ. Konkretisht, në nenin 60, pika 6, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet detyrimi i zhvillimit të një ecurie të vetme disiplinore, për të njëjtën shkelje të pretenduar dhe marrjen e një mase të vetme disiplinore.

Në rastin konkret konstatohet se ka më shumë se një ecuri disiplinore për të njëjtin veprim të kundërligjshëm, të pretenduar; konkretisht, me shkresën nr. 252 prot., datë 26.07.2016 ka filluar ecuria e parë disiplinore. Pas zhvillimit të seancës dëgjimore të caktuar më datë 02.08.2016 për shqyrtimin e saj, për të cilën është mbajtur procesverbali përkatës, rezulton se, me një shkresë tjetër, me nr. 276 prot., datë 04.08.2016, nëpunësja ***** është njoftuar për nisjen e një ecurie të dytë disiplinore, për të njëjtën shkelje disiplinore. Pretendimi i nëpunëses ***** ,

se ndaj ankueses nuk është nisur një ecuri e dytë disiplinore, vjen në kundërshtim me vetë përmbajtjen e akteve të nënshkruara prej saj, konkretisht me shkresën nr. 276, datë 04.08.2016, e cila ka emërtesën *“Nisja e ecurisë disiplinore me pretendimin për shkelje të rregullave të etikës me eprorët dhe kolegët”*. Njëkohësisht, nga përmbajtja e procesverbalit të mbajtur në seancën e datës 02.08.2016, nuk rezulton të ketë një vendim të ndërmjetëm për shtyrjen e saj, për të përligjur vazhdimësinë e procedimit disiplinor.

Bazuar sa më sipër, në analizë të gjithë dokumentacionit të administruar, arrihet në përfundimin se, procedura e ndjekur për marrjen e masës disiplinore ndaj nëpunëses *****, është një procedurë e kryer në mungesë të kompetencës ligjore dhe në kundërshtim me procedurën, e përcaktuar në legjislacionin në fuqi të shërbimit civil. Ekzistenca e këtyre elementëve të kundërligjshëm, në zbatim të nenit 108, pika i) dhe ii), germa a), të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, e bën vendimin nr. 329 prot, datë 16.09.2016, *“Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”*”, absolutisht të pavlefshëm dhe në vështrim të nenit 109, pika a), b) dhe d), të ligjit në fjalë, për mungesë të kompetencës dhe mosrespektim të procedurës, e bën aktin administrativ dhe procedurën disiplinore të paligjshme.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë, veprimi administrativ i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse ai është konstatuar si i tillë apo jo. Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, vetë organi publik, në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Patentave dhe Markave, duhet të konstatojë ekzistencën në këtë veprim administrativ të rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të bëjë anulimin e vendimit nr. 329 prot, datë 16.09.2016, *“Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”*”.

Duke qenë se në bazë të pikës 2, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, anulimi i aktit ka pasojë për të shkuarën, për rregullimin e ligjshmërisë së këtij rasti, njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, duhet të fshijë masën disiplinore *“Vërejtje”*, të marrë ndaj nëpunëses *****, nga dosja personale e saj, si dhe nga regjistri përkatës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga autoriteti publik, Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave, të drejtojë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 329 prot, datë 16.09.2016, *“Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”*”, ndaj nëpunëses *****, *“Specialiste në Sektorin e Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve”*, në Drejtorinë e

Përgjithshme të Patentave dhe Markave, duke vendosur anulimin e këtij akti, si një akt i dalë në kapërcim të kompetencave dhe në kundërshtim me procedurën.

2. Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, duhet të fshijë masën disiplinore nga dosja personale e nëpunëses ***** dhe nga regjistri përkatës dhe të njoftojë njësinë përgjegjëse, Departamentin e Administratës Publike, në lidhje me këtë veprim administrativ.
3. Institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave duhet të vijojë me pagimin e shtesës së pagës për nëpunësen *****, për shkak të natyrës së veçantë të pozicionit të punës, nga data e lindjes së kësaj të drejte, cila i është njohur dhe miratuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, është i detyruar të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA